



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-180/1**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-180/2

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080, dhe Nenit 18.1.12 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 Maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Rregullorja nr. 02/2023 për amandamentimin e Rregullores nr. 04/2022 Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për aprovimin e ndryshimeve lidhur me Rregulloren nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Ky vendim është marr me qëllim të përcaktimit të dispozitës ligjore për miratimin e çmimit të qirave në rastet kur qiramarrës janë institucionet publike të Republikës së Kosovës respektivisht ku çmimi përfundimtar i qirasë do të miratohet nga Bordi i AKP-së duke marrë parasysh faktor të ndryshëm me arsyeshmëri të interesit publik.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Maj 2023



Syzana Dautaj Surdulli
Zëvendës Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-180/3

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Neni 9 par. 5 i Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 10, paragrafi 1.2 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 2 i Rregullores 02/2023 për Plotësim/Ndryshimit të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore aprovuar me 17 maj 2023 dhe, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 Maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet zbritja e qirasë për qiramarrësin Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor për shfrytëzimin e zyrave nr.342; 344; 345 dhe zyrës nr.347 nga shuma 2,305.04 Euro (bruto) sipas kontratës nr. protokollit 44499/2023 të datës 24 janar 2023 në shumën prej 2,000.00 Euro (bruto) për asetin e NSH Jugobanka në Mitrovicë.
- II. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor do të jetë i obliguar që të paguajë shumën prej 2,000.00 €/muaj (bruto).
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për zbritje të çmimit të qirasë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor që ishte përcaktuar me vendim të Bordit nr. ref. BD-174-57 të datës 23.12.2022 siç është përshkruar në paragrafin I të këtij vendimi.

Duke pasur parasysh që Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor është pjesë e rëndësishme e institucioneve të Kosovës, i cili mbron dhe përfaqëson vlerat kulturore të vendit tonë dhe të cilit i nevojiten hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konsiderojmë që zbritja e qirasë është e arsyeshme dhe do të i mundësonte vazhdimin e kontratës së qirasë edhe Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor karshi limiteve buxhetore që kanë dhe në të njëjtën kohë do të mundësonte inkasimin e pandërprerë të të hyrave për NSH "NewCo Grand Hotel".

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Maj 2023.




Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ees.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-180/4

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, neni 10, paragrafi 1.2 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 2 i Rregullores 02/2023 për Plotësim/Ndryshimit të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore aprovuar me 17 maj 2023, neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, sipas nenit 6 paragrafi 4 dhe Neni 7 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-18 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 Maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelës depoz me sipërfaqe 49544 m² në pronësi të NSh "Ina Trgovina" PRN149, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 20,000.00 (bruto) për një (1) vit.
- II. Sipas nenit 6 paragrafi 4 dhe Neni 7 paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-18 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme kohëzgjatja e kontratës së qirasë është gjashtë (6) vjeçare.
- III. Udhëzohet Menaxhmenti që në koordinim me departamentin ligjor dhe Autoritetin e Likuidimit të shtojë një nen apo klauzolë përmes së cilës AKP nuk do të mbahet përgjegjëse në rast të transformimit pronësor nga AKP apo bartjen e kësaj prone te Fondi Sovran apo institucionet pasardhëse të AKP-së vendosin që kontrata të ndërpritet para afatit 6 (gjashtë) vjeçar.
- IV. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e AL-së, se lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë konform Neni 2 të Rregullores 02/2023 për Plotësim/Ndryshimit të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore aprovuar me 17 maj 2023 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, më datë 26 prill 2023 kemi pranuar e-mail nga përfaqësuesit e MINT që deklarojnë që në lidhje me qiranë specifike, kanë të destinuar shumën prej 20,000.00 Euro në vit.

Shfrytëzimi i depoz nga ana e MINT është e rëndësishme së veçantë dhe në të mirë të interesit publik për arsye se në këtë rast do të mundësohej sigurimi i rezervuarve të naftës, saktësisht për vendosjen e produkteve të naftës të konfiskuara dhe në këtë rast aktiviteti i tillë nuk paraqet aktivitet fitimprurës për institucionin në fjalë, përmes të cilit do të gjeneronte të hyra. Duke pas parasysh interesin publik sipas nenit 6 paragrafin 4 dhe Nenin 7 paragrafin 7 të Ligjit Nr.08/L-18 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme – qiraja është gjashtë (6) vjeçare.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Qiradhënia e asetit në fjalë do të shërbente edhe për mirëmbajtjen e asetit dhe do të zvogëlonte shpenzimet e fondeve të AKP-së për mirëmbajtjen e tij.

Shpenzimet e fondeve të likuidimit të NSH "Ina Trgovina" për mirëmbajtjen e këtij aseti janë mjaft të larta. Po ashtu Autoriteti i Likuidimit ka konsideruar se me lidhjen e kontratës së qirasë shpenzimet e fondeve të likuidimit do të zvogëloheshin dukshëm.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Maj 2023.



Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-180/5

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, neni 10, paragrafi 1.2 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 2 i Rregullores 02/2023 për Plotësim/Ndryshimit të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore aprovuar me 17 maj 2023, si dhe neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 Maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirave afariste në katet një, dy dhe tre të ndërtesës administrative nr. 2 (e njohur më parë si ish Bankos), me sipërfaqe totale prej 562.9 m² në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 2,000.00 për një (1) muaj sipas kërkesës së Këshillit Gjyqësor i Kosovës për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.**
- II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Autoritetit të Likuidimit, se lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Këshilli Gjyqësor i Kosovës për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë konform ndryshimeve të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që asetit do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, më datë 10 maj 2023 është pranuar e-mail nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së, në të cilën kanë deklaruar se kanë të destinuar shumën prej 2,000.00 Euro në muaj.

Shfrytëzimi i këtyre hapësirave është i rëndësishëm së veçantë dhe në interesin publik, për arsye se këto hapësira do të shfrytëzohen nga ana e punonjësve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Qiradhënia e asetit në fjalë do të shërbente edhe për mirëmbajtjen e asetit dhe do të zvogëlonte shpenzimet e fondeve të AKP-së për mirëmbajtjen e tij.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Maj 2023.




Syzana Dautaj - Surdufli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-180/6

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësim me nr. 10/132 të datës 08 Mars 2023, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 Maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Autorizohet Drejtori Menaxhues i AKP-së që të nënshkruaj “Marrëveshjen e Mirëkuptimit” me Komunën e Podujevës për pagesën e shpronësimit të pronave të paluajtshme të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019) në shumën 908,554,68€ për 20%-in e listave të punëtorëve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për përcaktimin e dinamikës së pagesës së shpronësimit për asetet e NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë.

Më datë 08 Mars 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 10/132 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë, nr.81-0, nr.89-0, nr.90-0, nr.187-0, nr.190-0, nr.192-0, nr.193-0, nr.510-0, nr.198-0, nr.199-0, nr.219-0, nr.220-0, nr.221-0, nr.222-0, nr.223-1, nr.224-1, nr.225-0, nr.226-1, nr.241-0, nr.509-0, nr.245-0, nr.266-0, nr.267-0 dhe nr.292-0 ZK Livadicë Komuna e Podujevës me sipërfaqe prej 279,798.41 m2 për realizimin e projektit: Ndërtimi i “Zonës Ekonomike Industriale”, në emër të Komunës së Podujevës. Më datë 26 Janar 2023 Ministria e Financave dhe Transfereve e ka bërë vlerësimin e pronave të paluajtshme të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019) në vlerën EUR 4,542,773.44.

Qëllimi i lidhjes së Marrëveshjes së Mirëkuptimit është rregullimi i dinamikës së pagesës së shumës së 20% në emër të shpronësimit.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Maj 2023.



Syzana Dautaj - Surdulli
Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës